



Duke u bazuar në kërkesën e bërë mbi përshtatshmërinë (pra që banesa ka të gjitha karakteristikat sipas rregullave në fuqi) e banesës, drejtuar Komunës së Campi Bisenzio, kërkuesi do të kontaktohet nga një teknik i komunës i cili do caktoj një takim për të kryer një inspektim në banesën për të cilën është kërkuar përshtatshmëria. Inspektimi ka për qëllim të verifikojë ngjashmërinë mes planimetrisë së banesës e cila është dorëzuar me kërkesën, me ambjentet e saj por mbi të gjitha verifikimin e karakteristikave higjieno/sanitare dhe të sigurisë sipas normativave në fuqi që një banesë të jetë e banueshme.

Gjatë inspektimit verifikimet kryesore që do bëhen janë:

- ngjashmëria e gjendjes së ambjenteve të banesës me planimetrinë e saj; pra verifikimi i lartësive të dhomave, të mureve ndarës, hapjet dhe përmasat e tyre, banjot, dhe adoptime të vogla etj.;
- Verifikimi i përdorimit të dhomave siç tregohet në planimetri;
- ekzistenca e hapjeve për ajrosje të parashikuara nga rregullat në fuqi tek dhomat ku përdoret gaz metan/gpl për gatim ose për impiantet termo-sanitare;
- verifikimi i prezencës dhe funksionimit të oxhakut thithës (cappa) sipër fërnjelës së gatimit me gaz si dhe tubacioni përkatës për nxjerrjen jashtë të avujve të gatimit dhe mbetjet kombustive nga djegia e gazit;
- verifikimi i prezencës në fërnjelën e gatimit me gaz i dispozitivit (termocoppia) që mban nën kontroll flakën, pra kur dispozitivi konstaton që ka flakë atëherë mban të hapur ushqyesin e gazit, dhe e ndërpret gazin në rast se nuk ka flakë;
- prania e një banjoje të kompletuar me: lavaman, bide, dush ose vask, VC; me dritare për ajrosje ose sistemin për ajrosje;
- prania e sistemit ngrohës dhe e ujit të ngrohtë si dhe gjeneratori në normë dhe me revizionin e bërë;
- prania e impiant elektrik të rregullt, prania e celsit elektrik të sigurecave;

IV Settore "Programmazione e Gestione del Territorio"	e-mail: amm.ed.privata@comune.campi-bisenzio.fi.it
U.O. 4.7 - Edilizia e Strumenti Attuativi - Comune di Campi Bisenzio	e-mail PEC: comune.campi-bisenzio@postacert.toscana.it
Piazza Dante 36 – 50013 Campi Bisenzio (FI)	P.I. 00421110487
tel. 055 8959439 (amm.) – 400 (tec.) fax 055 89594	C.F. 80016750483